



---

**VENDIM**

***Nr.194, Datë 30.12.2016***

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SH.A. LIDHUR  
ME MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT,  
SHËRBIMET NDIHMËSE DHE DISBALANCAT**

Në mbështetje të neneve 1; 16 dhe 62 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM nr. 244 datë 30.03.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.12.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me kërkesen e OST sh.a nr. 701/1 prot, datë 14.10.2016 OST sh.a. për problematikën mbi mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik.

Konstatoi se :

- Aktualisht në tregun shqiptar të energjisë elektrike vetëm njësitë gjeneruese të të licensuarit KESH sh.a. mund të shërbejnë për sigurimin e shërbimeve ndihmëse.
- Neni 1 i Ligjit nr. 43/2015, Për Sektorin e Energjisë Elektrike parashikon se: *“Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit“;*
- MEI me shkresën Nr. 4514/1 Prot., datë 03.08.2016, ka dërguar në ERE qëndrimin e saj lidhur me kërkesën e OST sh.a për lënien të pandryshuar edhe për 6-mujorin e dytë të vitit 2016 të çmimit të energjisë elektrike që OST sh.a i paguan KESH sh.a, për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.
- ERE ka kërkuar edhe në vijim opinionin e MEI në lidhje me kërkesën e OST sh.a nr. 701/1 prot, datë 14.10.2016 OST sh.a. për problematikën mbi

sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik duke konstatuar të njëjtat rrethana dhe kushte që lidhen me shërbimet ndihmëse dhe sigurimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.

- Me Vendimin nr.190, datë 22.12.2016 u vendos lënia në fuqi e Vendimit nr. 145, datë 26.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2015“. ( Tarifë kjo e cila reflekton sigurimin e shërbimeve ndihmëse ndihmëse dhe humbjeve në rrjetin e sistemit të transmetimit përmes KESH sh.a),

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

### **Vendosi:**

1. OST sh.a të lidh kontratë bilaterale me pjesëtarin e tregut KESH sh.a, për të siguruar shërbimet ndihmëse dhe balancimit për vitin 2017, sipas marrëveshjes së miratuar me Vendimin nr. 79, datë 07.06.2016 “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektroenergjitik” midis OST sh.a dhe KESH sh.a dhe në përputhje me çmimin e përcaktuar sipas Vendimit të Bordit të ERE-s nr.141 datë 26.12.2014..
2. Deri në miratimin e tarifës së Transmetimit të energjisë elektrike për të cilën kanë filluar procedurat me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.191, datë 22.12.2016, për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, OST sh.a të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e Kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, miratuar me Vendimin Nr. 78, datë 07.06.2016 të Bordit të ERE.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë , KESH sh.a dhe OST sh.a, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.